



Portali

Bibla Shqip

Materiale

Apologjia

Fete & Kultet

Burime-Info

Kush Jemi

Abonohuni

Vizioni ynë:

*"Që t'ju shërbejmë
shqiptarëve për
Krishtin."*

Lindja Virgjërore na solli Perëndinë ! ([versioni online](#))

E gjithë kjo ndodhi që të përmbushej ajo që u tha prej Zotit, me anë të profetit, duke thënë: "Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, dhe do t'i vënë emrin Emanuel, që e përkthyer do të thotë: 'Perëndia me ne'" (Mt. 1:22-23).

Emrat hebraikë kishin një kuptim të veçantë. Emanuel është një emër i përbërë prej dy fjalësh Emmanu (me ne) dhe El (Perëndia). Megjithëse Jezusi ishte "njeriu me ne," ai ishte gjithashtu "Perëndia me ne." Lindja Virgjërore na solli Perëndinë, Birin e Amshuar. Një arsye pse ne e besojmë këtë është sepse Bibla e thotë.

Historia që vijon ilustron një arsye të dytë përse ne besojmë në Lindjen Virgjërore.

Vite më parë ishte një profesor i vjetër i cili besonte në lindjen virgjërore të Krishtit. Disa profesorë të tjerë liberalë e tallnin atë për shkak të këtij besimi. Njëri prej tyre tha: "Supozoni sikur një grua e re të hynte sot në spitalin këtu pranë. Po të kishte një foshnje djalë dhe të pretendonte se ishte e virgjër, a do ta besonit?"

Profesori i vjetër lëmoi mjekrën e tij dhe heshti për një çast. Pastaj u përgjigj: "Jo, ndoshta nuk do ta besoja. Megjithatë, në qoftë se ai foshnje djalë do të rritej dhe do të bëhej burrë;

- nëse do të mundej të hapte sytë e të verbërve,
- nëse do të mundej t'i bënte të calet të ecnin,
- nëse do të mundej të pastronte leprozët,
- nëse do të mundej të ngrinte të vdekurit,
- nëse do të thërriste një grup të vogël pasuesish dhe do të ndryshonte rrënjësisht jetën e tyre,
- nëse do të vdiste si një kriminel i dënuar, por do të ngrihej nga të vdekurit,
- nëse do të ndryshonte ecurinë e historisë së botës,
- nëse, pas 2000 vjetësh, një e treta e popullsisë së botës do ta quante Shpëtimtar dhe Zot,
- nëse të gjithë ata njerëz do të shpallnin se e njihnin praninë e tij të gjallë në zemrat e tyre,

ATËHERË UNË DO TA DËGJOJA HISTORINË E ASAJ GRUAJE PËR SË DYTII!"
Ne e besojmë lindjen virgjërore të Jezusit për shkak të jetës dhe fuqisë së tij.

Doktrina e Mësimit të begatisë ([versioni online](#))

Doktrina e quajtur shpesh mësimi i begatisë, thotë se begatia materiale është shenja e bekimit të Perëndisë. Sipas disa prej mbështetësve të saj, fjala farë tek Marku 4:8 ka kuptimin e parasë, që një person jep në kishë

apo në ndonjë shërbesë tjetër të krishterë. Meqenëse fara, për të cilën flet vargu: "Dha fryt që rritej, dhe shtohet dhe mbante njëra tridhjetë, tjetra gjashtëdhjetë dhe tjetra njëqind", kjo tregon, sipas këtyre mësuesve, se personi që jep mund të jetë tërësisht i sigurt se ky investim do t'i kthehet në vlerë monetare shumë herë më shumë.

Mësimi i "begatisë" dështon sepse ai, si shumë doktrina të tjera të rreme, mbithekson një të vërtetë në kurriz të një tjetre. Ajo është një pikëpamje e paekuilibruar dhe e shtrembëruar. Sipas Mateut 6:33, Perëndia ka premtuar se do të plotësojë nevojat e atyre që kërkojnë së pari mbretërinë e Tij. Por kjo është një çështje që qëndron shumë larg nga premtimi për t'i pasuruar të gjithë të krishterët me anë të standardeve të botës.

Bibla dokumenton jetët e shumë burrave dhe grave të perëndishme, përfshi edhe Palin, të cilët përjetuan kohë ngushtice dhe varfërie materiale (2 Korintasve 6:3-10). Vetë Jezusi tha se Ai nuk kishte asnjë vend ku të vinte kokën (Mateu 8:20). Ai hyri në Jeruzalem mbi një gomar, që ishte marrë me qera (Luka 19:28-35). Madje në vdekjen e Tij ia morën edhe rrobat (Luka 23:34). A mos vallë mungesa e të mirave të kësaj bote ku u gjend Ai do të thotë se Perëndia nuk ishte i kënaqur me Të? Sigurisht që jo.

Ideja se zotërimi i pasurisë është automatikisht një shenjë e bekimit të Perëndisë mbi një të krishterë është një gabim. Ne nuk duhet të kemi turp nga të qenit i varfër, nëse kjo është gjendja jonë.

Disa nga shenjtorët më të mëdhenj nuk kanë pasur gjë tjetër veçse rrobat që vishnin. Në të njëjtën kohë, ne as nuk duhet të krenohemi se jemi të varfër! Varfëria nuk është një dëshmi e të qenit frymëror. Bibla na mëson se qëllimi i Perëndisë nuk është që të na bëjë të pasur ose të varfër, por që të na japë formë në imazhin e Birit të Tij (Romakëve 8:29). Jezusi dha gjithçka kishte për të na shpëtuar. Dëshira për t'u dhënë të tjerëve, ashtu siç bëri Ai, pavarësisht nëse kemi shumë apo pak, duhet të jetë motivi ynë për të dhënë (2 Korintasve 8:9).

Kjo nuk do të thotë që gjërat materiale nuk janë frymërore, sepse ne e pohojmë me siguri që Perëndia ynë është bujar. Ai na jep në një masë shumë më të madhe sesa ajo që ne i kemi dhënë ndonjëherë Atij. Ashtu siç tha edhe Vetë Jezusi tek Luka 6:38: "Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t'ju jepet në prehër, sepse me atë masë që do të matni, do t'ju matet edhe juve përsëri". Vini re standardin: është masa me të cilën masim. Ndonjëherë ky shpërblim merr formën e begatisë materiale, ashtu siç Pali nuk hezitoi t'u thoshte korintasve. "Por ju them këtë: Ai që mbjell me kursim, do të korrë po me kursim", tha ai "dhe ai që mbjell me bujari edhe do të korrë me bujari" (2 Korintasve 9:6).

Ne mund të mos jemi dakord me disa nga gjërat që thonë miqtë tanë të mësimin të begatisë, por ne mund t'i falenderojmë ata që na kujtojnë se Perëndia ynë është një Perëndi bujar. Ai do të na bekojë si materialisht ashtu edhe frymërisht, ashtu si të zgjedhë Ai.

Një studim e asaj që thotë Bibla mbi gjërat materiale na drejton tek pesë parimet e mëposhtëm. Unë besoj se ato do të na ndihmojnë që të mbajmë një pikëpamje të ekuilibruar dhe biblike.

1. Ne nuk duhet ta bëjmë pasurinë perëndinë tonë (Mateu 6:24; 1 Timoteut 6:5; Jakobi 4:1-3).
2. Ne duhet të mësojmë që të jemi dhënë të gëzuar (2 Korintasve 9:7).
3. Ne duhet të japim të paktën një të dhjetën e të ardhurave tona për të mbështetur veprën e Perëndisë (Malakia 3:6-12; Mateu 23:23).

4. Ne duhet të mësojmë që t'ia dalim mbanë edhe pa patur, kur ky është vullneti i Perëndisë për ne (Filipianëve 4:12-13).
5. Ne duhet të kuptojmë parimin më të madh, i cili është: "Më lum është të japësh sesa të marrësh!" (Veprat 20:35).
-



albKristian.com

E-mail: buletini@albKristian.com

Kush Jemi: [Stafi i albKristian.com](http://Stafi.i.albKristian.com)

Copyright © 2002 albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare
Buletini albKristian.com eshte nje sherbese e albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare. Nuk lejohet asnje lloj perdorimi per qellime fitimi apo komerciale te cfaredo lloj forme. Mund te printohet, shperndahet dhe perdoret falas ose per qellime jofitimprurese pa lejen e autorit. Per cdo lloj perdorimi tjeter ju lutem na kontaktoni paraprakisht per leje.

[Abonohuni tek Buletini i albKristian.com](#)